

VENDIM
Nr. 612, datë 29.7.2020

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 656, DATË 31.10.2018, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË
PËRHERSHME TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të lidhjes nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, shtohet lidhja që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për komisionet/këshillat/bordet, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, fillojnë nga momenti i funksionimit të tyre dhe përballohen, përkatësisht, nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i Ministrisë së Kulturës.

Efektet financiare për Komisionin e Policisë Gjyqësore përballohen nga buxheti i secilit institucion, të përfaqësuar në këtë komision.

3. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Emertesa e Bordit/Keshillit/Komisionit	Numri maksimal i pagesave ne nje vit	Përbërja		Masa e shperblimit në Lekë	
		Kryetari	Nr. i Anetareve	Kryetari	Anëtari
Komisioni i Policisë Gjyqësore	12	1	4	20,000	15,000
Komisioni Qendror i Statusit "Dëshmor i Atdheut"	5	1	6	7,000	7,000
Bordi i Administrimit të Fondit Social të Punësimit	6		9		10,000
Këshillat Konsultativ Trepalësh Rajonal	4	1	14	5000	5000
Zyra Kombëtare e Pajtimit		1	4		Paga ditore e Dr. Drejtorise * nr. i diteve per pjesemarrje ne mbledhje
Zyrat Rajonale të Pajtimit		1	4		Paga ditore Dr.te Zyres Rajonale * nr. i diteve per pjesemarrje ne mbledhje
Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale	4	1	14	5,000	5,000
Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Jomateriale	4	1	10	5,000	5,000
Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore	6	1	10	5000	5000
Këshilli Kombëtar i Muzeve	4	1	10	5,000	5,000